



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3696/ 14 prot.

Datë 28/02/2025

V E N D I M
Nr. 311/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28/02/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 230/2025, datë 12.02.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-12184-07-04-2024, me objekt “Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a për dy vjet” me fond limit: 39,848,500 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Filara” SHPK me NIPT K51611059N, me adresa: Rruga “Kavajës”, Ish Kombinati “Misto Mane”, Pranë fabrikës Kaon, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
Adresë: Blv “Gj. Fishta”, Nd.Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 12.02.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 230/2025, ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-12184-07-04-2024, me objekt “Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet” me fond limit: 39,848,500 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Filara” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1707/2 prot., datë 25.02.2025, protokolluar me tonën nr. 3696/11 prot., datë 27.02.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 230/2025, datë 12.02.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e

lartë monetar” me Nr. REF-12184-07-04-2024, me objekt “Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet” me fond limit: 39,848,500 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1707/2 prot., datë 25.02.2025, protokolluar me tonën nr. 3696/11 prot., datë 27.02.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 230/2025, datë 12.02.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar”* me Nr. REF-12184-07-04-2024, me objekt *“Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet”* me fond limit: 39,848,500 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 230/2025 datë 12.02.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke rishikuar statusin operatorit ekonomik *“Filara”* SHPK ku nga i skualifikuar rezulton i kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 230/2025, datë 12.02.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për*

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-12184-07-04-2024, me objekt “*Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet*” me fond limit: 39,848,500 (*tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind*) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (*treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë*) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

